



# Biolid® UP



BIOLID® UP

VAJ MINERAL I PARAFINUAR  
ME VEPRIM KONTAKTI

- Insekticid-akaricid
- I përshtatshëm për trajtimet pranverore-verore
- Insekticid selektiv me spektër të gjerë veprimi



## **Breshkëza pambukore e hardhisë**

Trupi i breshkëzës ka ngjyrë kafe gështenjë, 4-8 mm i gjatë dhe 3-5 mm i gjerë. Mjaft karakteristike janë fijet dyllore me ngjyrë të bardhë që lëshon breshkëza në pjesën fundore të trupit. Zakonisht në vendet ku dëmton breshkëza mbi lëngun sheqeror të lëshuar prej saj zhvillohen këpurdhat e tymthit. Janë dëmtues të rrezikshëm, pasi dëmet e shkaktuara prej tyre pengojnë zhvillimin normal të hardhive dhe influencojnë direkt në uljen e sasisë dhe cilësisë së prodhimit.



**Brëshkeza pambukore e hardhisë**  
(*pulvinaria vitis*)

## **BRESHKËZA PAMBUKORE E LIMONIT**

Është e përhapur në vendin tonë në zonat e ulta dhe në ato bregdetare. Prek agrumet, sidomos limonin, hardhinë, fikun, shegën, dafinën, koleusin dhe shumë lule e bimë zbukuruese. Prek gjithë, degët dhe frutat. Si pasojë e thithjes së lëngjeve ushqyese, gjetet dhe frutat dobësohen dhe rrëzohen para kohe. Njëkohësisht mbi ekskrementët që nxjerr breshkëza gjatë thithjes në gjethe, fruta dhe lastarët shfaqet tymthi.



**Breshkëza pambukore e limonit**  
(*Pseudococcus citri* Risso)

## **BRESHKËZA E BARDHË**

Është e përhapur në të gjitha zonat ku kultivohen agrumet. Është dëmtues polifag. Prek si bimët e përmirsuara ashtu edhe ato zbukuruese e të egra. Prek rrushin frëng, ricinin, trifilin, pataten dhe veçanërisht agrumet, ullirin, më pak pemët e tjera frutore, pastaj ligustrën, akacien, asparagusin, kaktuset, dafinën, mimozen, agaven, jargavanin, palmat, sidomos leandrin etj.



**Breshkëza e bardhë**  
(*Aspidiotus hederae* Vallot)

# BIOLID® UP

Përbërja	Vaj mineral CAS 97862-82-3 (me 95% tretshmëri) 80%
Formulimi	Lëng i emulsionueshëm
Grupimi	IRAC NC
N. regjistrimit	Produkt në proces regjistrimi
Konfeksioni	1 L (x 10), 5 L (x 4), 25 L




## BIOLID® UP

**Vaj mineral me pastërti dhe selektivitet shumë të lartë për të gjitha kulturat si më poshtë.**

### KARAKTERISTIKAT

BIOLID UP është vaj mineral i cili karakterizohet nga shkalla e lartë e pastërtisë. BIOLID UP rezulton që është shumë selektiv kundrejt kulturave të drufrutorëve (arboree) dhe bimët e arave edhe në trajtimet në vegjetacion. Vepron kryesisht me anë të kontaktit tek vezët dhe insektet e rritur dhe merimangat (akarinat). Këshillohet të përdoret edhe si lëndë ndihmëse për herbicidet.

**Lejohet përdorimi në bujqësinë Biologjike.**



KULTURAT	DËMTUESIT	MËNYRA PËRDORIMIT	KARENCA
PEMË FRUTORE ME FARË (Mollë, Dardhë)	Psillat	1,5-2 l/hl	20 ditë
	Akarinat, Breshkëzat, Eriofidet, Çikalinat, Metcalfa, Morrat	0,5-1,2 l/hl	
PEMË FRUTORE ME BËRTHAMË	Breshkëzat, Merimanga e kuqe, Morrat, Çikalinat, Eriofidet, Metcalfa	0,5-1,2 l/hl	20 ditë
ULLINJ	Breshkëzat	1-1,5 l/hl	20 ditë
AGRUME	Breshkëzat, Minatrici e gjetheve	1,5-2 l/hl	20 ditë
	Morrat, Çimka jeshile, Akarinat, Aleurodidët	0,5-1,2 l/hl	
VRESHTA	Breshkëzat, Akarinat, Cimkat, Metcalfa	0,5-1,2 l/hl	20 ditë
ARRË, BAJAME	Morrat, Breshkëzat	0,5-1,2 l/hl	20 ditë
BIMË ZBUKURUESE, PYJORE, ME LULE	Breshkëzat, Akarinat, Morrat, Aleurodidët, Lepidopterët, Dipteret, Psillat, Çikalinat, Tinxhidet, Metcalfa	0,5-1,2 l/hl	-
LAJTHI	Çimkat, Eriofidet, Morrat	0,5-1,2 l/hl	20 ditë
FIK, HURM	Psillat, Çikalinat, Metcalfa, Breshkëzat	0,5-1,2 l/hl	20 ditë
BORONICË	Morrat, Breshkëzat	0,5-1,2 l/hl	20 ditë
FASULE	Morrat, Akarinat, Tripset	0,5-1,2 l/hl	20 ditë

KULTURAT	DËMTUESIT	MËNYRA PËRDORIMIT	KARENCA
SPEC, DOMATE, PATATE	Morrat, Akarinat, Dipteret	0,5-1,2 l/hl	20 ditë
KUNGULLORË	Morrat e pambukut, Aleurodidët, Tripset, Akarinat, Dipteret	0,5-1,2 l/hl	20 ditë
ARGJINARE, SELINO, FINOK	Morrat, Aleurodidët, Akarinat, Lepidopterët, Dipteret	0,5-1,2 l/hl	20 ditë

### PËRDORIMI NË PËRZIERJE ME HERBICIDET POST-EMERGJENCË

KULTURAT	MËNYRA PËRDORIMIT	KARENCA
PANXHAR-SHEQERI	0,3-1 l/ha	20 ditë
PATATE, SPEC, DOMATE, LULESHTRYDHE, ANGJINARE, SELINO, FINOK	0,3-1,5 l/ha	20 ditë
MISËR, DRITHËRA VJESHTORE-DIMËRORE	0,3-1,5 l/ha	20 ditë